



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.193/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.04.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k dhe “Adastra” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-05758-01-30-2019, me objekt: “*Blerje artikuj për bashkinë Vorë*” me fond limit 1.666.620 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

Ankimues:

“Erisoni Company” shpk
L.6, Rruga Bashkimi, Durrës

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vorë
Qyteti Vorë

Subjekt i Interesuar:

“Adastra” shpk
Rruga “Lejla Veranda”, Tiranë

“Infosoft Office” shpk
Autostrada TR-DR, km8, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.01.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-05758-01-30-2019, me objekt: “Blerje artikuj për bashkinë Vorë” me fond limit 1.666.620 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

II.2. Në datën 20.02.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 20.02.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Infosoft Office	1,037,000	I kualifikuar
- Adastra	1,177,000	I kualifikuar
- Erisoni Company	1,205,795	I kualifikuar
- Interlogistic	1,205,871	I skualifikuar
- Adenis Kastrati	1,215,450	I skualifikuar
- IT Gjergji Kompjuter	1,457,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 25.02.2019, operatori ekonomik ankimues “Erisoni Company” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Te kriteret e vecanta të kualifikimit ju si AK në pikën 2.2.5 keni kërkuar:*

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në magazinën e Autoritetit Kontraktor mostra per letren A4 dhe bojrat, ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit. Ne rast se nuk do te paraqiten mostra, do te kete mangesi ne produktet e dorezuara, ose nuk do te kete perputhje me specifikimet teknike, ky do te jete nje kusht per skualifikim. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar. Në datën 11.02.2019 ora 10:00 u mbajt procesverbali për hapjen e mostrave që u firmos nga palët pjesmarrëse, operatorët ekonomikë të pranishëm dhe përfaqësues të Bashkisë Vorë rezulton se: Operatorët e kualifikuar Infosoft Office nuk kishte përputhje me specifikimet teknike për 2 artikuj: te set artikulli numër 1 përkatësisht Bojë fotokopje RICOH Aficio MP C3501 CYMK HC, PN 842047/841426/841427. Boja magenta është e mbushur dhe pa ambalazhin përkatës. Tek artikulli nr.8 përkatësisht Bojë printer lex marke MS 310D PN 50F2H00. Kuti e bojës është shumë më e vogël se përmasat standarte që ka kutia e

boojës origjinale krahasuar edhe me kutitë e bojrave që kishin sjellë operatorët e tjerë për këtë lloj modeli boje. U verifikua edhe nga përfaqësuesi i këtij operatori i cili ra dakord që kishte problem me mostrat përkatësisht me bojën e mbushur të artikullit nr.1 dhe me artikullin nr.8 që është më i vogël. Këto specifikime e theksuar edhe nga kërkesat e vecanta të kualifikimit që ju keni vendosur përbën kusht për skualifikim pika 2.5.5.

- Operatori tjetër i kualifikuar Adastra kishte problem me artikullin me nr.17 përkatësisht: Bojë pronteri Samsung ML 1915 MLT-D1052L me tirazh të madh 2500 faqe që ishte kërkuar nga ju. Ky operator kishte sjellë bojën Samsung ML 1915 MLT-D1052S me tirazh të vogël 1500 faqe.

Te set artikulli nr.1 Bojë fotokopje RICOH Aficio MP C3501CYMK HC PN 842047/841425/841426/841427. Ambalazhi i bojës cyan ishte i dëmtuar.

U verifikua edhe nga përfaqësuesi i këtij operatori i cili ra dakord që kishte problem me mostrat përkatësisht me artikullin nr.17 dhe me artikullin nr.1. Këto specifikime e theksuar edhe nga kërkesat e vecanta të kualifikimit që ju keni vendosur përbën kusht për skualifikim pika 2.2.5.

Sa më sipër venidmi i KVO për kualifikimin e OE Infosoft dhe Adastra është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 53, 55,66 të LPP. Kërkojmë skualifikimin e operatorëve ekonomikë Infosoft Office dhe Adastra shpk.

II.5. Në datën 27.02.2019 me shkresën nr. 1074/4 prot operatori ekonomik ankimues “Erisoni Company” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 06.03.2019, pala ankimuese “Erisoni Company” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.1581/2 prot, datë 21.03.2019 prot me tonën me nr.393/2 prot datë 25.03.2019, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Compnay” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk dhe Adastra shpk me arsyetimin se “*nuk kanë paraitur mostra në përputhje me specifikimet teknike*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.2.5 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në magazinën e Autoritetit Kontraktor mostra per letren A4 dhe bojrat, ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit. Ne rast se nuk do te paraqiten mostra, do te kete mangesi ne produktet e dorezuara, ose nuk do te kete perputhje me specifikimet teknike, ky do te jete nje kusht per skualifikim. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar.

III.1.2. Në shtojcën 9 “specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Tonerat për printerat dhe fotokopjet nuk duhet te jene tonera kompatibel, të ricikluara, të rimbushura, apo cdo lloj toneri ekuivalent qofte ky dhe i certifikuar.

Numri serial i kutise duhet te jete i njejte me numrin serial te bojes.

Bojrat te jene sipas kapacitetit te kerkuar.

Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit.

1. Specifikimet e letrës A4:

Te dhenat teknike te letres

- a - Cilësi e parë me certifikatë Iso*
- b - CIE Bardhësi: 164 - 170*
- c - Pësha e një fije 80 gr/m² dhe një rizme (500 fije x A4)*
- d - Përmasat të jenë 210 x 297 cm*
- e - Multifunkionale – për fotokopje, printer, faks.*
- f - Lagështira: 3.5 – 4.5 %*
- g - Trashësia: 108 – 112 µm*
- h - Drita: >= 95 %*
- i - Shkëlqimi: 101-114%*

Specifikimet teknike te kerkuara me siper te vertetohen duke paraqitur ne tender skeden teknike (te perktyer dhe noterizuar).

- *Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma*
- *Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in*
- *Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit*
- *Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit*
- *Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët*
- *Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.*
- *Të jetë Ultra Bright, Silky Touch.*
- *te jete 99.99% Paper Jam Free.*
- *te kete sipërfaqe te përmirësuar: Për cilësinë më të mirë të printimit dhe konsumin e tonerit me te ulët.*

III.1.3. Në shtojcën 10 "sasia dhe grafiku i lëvrimit" të dokumentave të procedurës së prokuirimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

<i>NR</i>	<i>Emertimi I artikujve</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Bojë fotokopje RICOH Aficio MP C3501 CYMK HC, PN 842047/841425/841426/841427;</i>	<i>Set</i>	<i>2</i>
<i>2</i>	<i>Bojë fotokopje RICOH Aficio MP C3501 Toner e zeze HC, PN 842047</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	<i>Bojë fotokopje Ecosys Fs -6525MEP TK475</i>	<i>Copë</i>	<i>5</i>
<i>4</i>	<i>Bojë fotokopje Ecosys M2035dn TK1140</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
<i>5</i>	<i>Bojë printeri ML 1640 MLT-D1082S</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
<i>6</i>	<i>Bojë printeri 1018 HP laser jet Q2612A</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
<i>7</i>	<i>Bojë printeri samsung 2160 MLT-D101S</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
<i>8</i>	<i>Bojë printeri lex marke MS 310 D PN 50F2H00</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
<i>9</i>	<i>Boje printeri oki B432</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>

10	Bojë printeri samsung 1660 MLT-D1042S	Copë	2
11	Bojë printeri samsung 1665 MLT-D1042S	Cope	2
12	Bojë printeri ST-D 111S(Xpress M2070 Samsung)	Copë	4
13	Bojë printeri Samsung Xpress M2022Ë MLT-D111S	Copë	3
14	Bojë printeri Epson Al-M200DN C13S050709	Copë	5
15	Bojë printeri Xerox Eorkcenter 5021 006R01573	Cope	2
16	Bojë printeri Kyocera ecosys 2135 dn TK-1150	Cope	33
17	Bojë printeri Samsung ML 1915 MLT-D1052L	Copë	2
18	Bojë printeri Ecosys 2040 TK-1160	Cope	4
19	Bojë printeri xpress M2675F MLT-D116S	Cope	4
20	Leter A4 / 80g sipas specifikimeve	Rismë	930

III.1.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr. 1581/2 prot, datë 21.03.2019 prot, rezulton se më datë 11.02.2019 është mbajtur procesverbali mbi hapjen e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik pjemarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nga ku rezulton se për operatorët ekonomikë Infosoft Office shpk dhe Adastra shpk citohet se:

Infosoft- tek set artikulli 1 Magenta është e mbushur, kutia është e vogël për artikullin nr.8. konstatohet më e vogël se e operatorëve të tjerë.

Adastra- Artikulli 17 është 1052S tirazh i vogël duhet 1052L. Set artikulli 1 Toner Blu i dëmtuar cian Palët pjesmarrësë bien dakord dhe firmosin.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.6. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.7. Në nenin 23, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”*

III.1.8. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.1.9. Në dokumentat e tenderit, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i Ofertës”, është përcaktuar shprehimisht: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

III.1.10. Referuar Procesverbalit të datës 11.02.2019 “Mbi Dorëzimin e Mostrave” për procedurën e prokurimit objekt ankimi mbajtur midis anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përfaqësuesve të shoqërisë pjesmarrëse, konstatohet se nga ana e operatorëve ekonomikë Infosoft Office dhe Adastra janë dorëzuar mostrat e artikujve të kërkuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, por ato nuk janë plotësisht në përputhje me specifikimet teknike. Ashtu sikundër edhe palët kanë pranuar për operatorin ekonomik Infosoft

Office janë konstatuar mospërputhje tek set artikulli nr.1 pasi boja Magenta është e mbushur, dhe tek artikulli nr.8 kutia është e vogël.

Ndërsa për operatorin ekonomik Adastra- kanë rezultuar mospërputhje lidhur me artikullin 17 nga ku është konstatuar se është me 1052S tirazh i vogël duhet 1052L, dhe për Set artikulli 1 nga ku është konstatuar Toner Blu i dëmtuar cian .

Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se është përcaktuar se në *rast se nuk do te paraqiten mostra, do te kete mangesi ne produktet e dorezuara, ose nuk do te kete perputhje me specifikimet teknike, ky do te jete nje kusht per skualifikim.*

KPP e gjen të drejtë pretendimin e ankimesit pasi gjykon se në kushtet kur në kriterin e kualifikimit është përcaktuar shprehimisht se nëse do të kete mangesi ne produktet e dorezuara, ose nuk do te kete perputhje me specifikimet teknike, ky do te jete nje kusht per skualifikim. , i takon operatorëve ekonomikë të paraqesin mostra në përputhje me të gjitha specifikimet e kërkuara .

Kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit përbën shkak për skualifikim.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;*

“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertesve ose kandidatëve”;

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë ”Infosoft Office” dhe ”Adastra” shpk nuk plotësojnë kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Company” shpk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-05758-01-30-2019, me objekt: “*Blerje artikuj për bashkinë Vorë*” me fond limit 1.666.620 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 20.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk dhe operatorit ekonomik “Adastra” shpk duke i skualifikuar ata.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 393 Protokolli; Datë 06.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha